

VENDIM
Nr. 355, datë 29.4.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 18 179 M², PJESE E PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM “SHA RIPARIM ARTILERIE”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të një sipërfaqeje prej 18 179 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim “Sh.a. Riparim Artilerie”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për administrimin, ruajtjen dhe për-punimin e dokumentacionit të Arkivit Qendror të Shtetit.

2. Sipërfaqja prej 18 179 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m², e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të shtohet sipërfaqja prej 18 179 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim “sh.a. Riparim Artilerie”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave i ndalohet të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.


5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan vendosja e prones nr.109 SHA Riparim Artilerie Brar,TIRANE.
(Sip. dhe objektet qe kerkohen per kalim nga Ministria e Mbrojtjes ne administrim te DPA.)

Sistemi i koordinatave shteterore



4 583 Punuar Maj 2014.

4 450
4 404 700

Punoi
Ing:Astrit JOCA

A-Joca

Shkalla 1:2500

Selman LLESHI
Pergj.Sekt. Gjeodezise

DREJTOR I I.GJ.U-së
N/Kol Armir ÇANI

